



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 304, Datë 23.10.2023

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEALB ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET “GURI I BARDHË 1” DHE “GURI I BARDHË 2”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 2 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2042/10 prot., datë 20.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “GEALB ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GEALB ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2042 prot., Datë 17.08.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2” dhe bordi i ERE-s, me vendimin nr. 256, datë 23.08.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.08.2023 dhe 25.08.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 22.09.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën me nr. 2042/3 prot., datë 30.08.2023 dhe e-mailin me nr. 2042/5 prot., datë 19.09.2023, nr. 2042/8 prot., datë 13.10.2023, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2042/4 prot., datë 15.09.2023, nr. 2042/6 prot., datë 21.09.2023, nr. 2042/7 prot., datë 02.10.2023, nr. 2042/9 prot., datë 16.10.2023 ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin sipas përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1 gërmat: “a”, “b”, “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat: “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat, “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.
- Shoqëria ka depozituar vërtetimin që rezulton se ka detyrime ndaj organeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ka deklaruar se këto detyrime do t’i shlyejë para fillimit të ndërtimit. Vlen të theksohet se ky vërtetim është një nga kërkesat e rregullores për licencim (neni 9, pika 1.3, gërma “a”), si e tillë lind nevoja që ky vërtetim të depozitohet në ERE sikurse kërkuar nga rregullorja dhe të kërkohen shpjegime përse nuk është kryer pagesa për sa kohë shoqëria ka aplikuar ë ERE për t’u licencuar.
- Në nenin 14, pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencim kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Për gjitha sa më sipër, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes përfundimtare të bordit mbi licencimin e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1”, “Guri i Bardhë 2”, në rrjedhën e përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër, me kapacitet të instaluar 9300 kW.
- Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k. duhet të depozitojë vërtetimin që ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj organeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si një nga kërkesat e rregullores për licencim pranë ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit mbi licencimin e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kW.
2. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k., duhet të depozitojë vërtetimin që ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj organeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si një nga kërkesat e rregullores për licencim pranë ERE-s.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Gealb Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI